



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE E UJËSJELLËS – KANALIZIME FIER SH.A

Nr. _____ prot

Fier, më ____/____/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Matesa mekanik uji dhe aksesor”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Mates te ujit
Kodi CPV 38421100-3

VLERA E FONDIT LIMIT:

11.998.916 (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Autoriteti/enti Kontraktor “Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-Kanalizime Fier” Sh.A, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

2.1.1 Të jetë qartësisht e specifikuar në QKB, se objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik është i njëjtë ose “ekuivalent” me objektin e prokurimit.

➤ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2019-2020-2021), **ku vlera mesatare e së cilës, të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës (vlera e fondit limit).** Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori Ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në *nenin 77 pika 3 i LPP*, si dhe *nenin 43 pika 2, gërma “b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*.

Përcaktimi i vlerës dhe i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, argumentohet si vijon: Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues, i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilanceve për vitet (2020-2021) të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në *nenin 43, pika 4 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* dhe i shërben AK që të vërtetojë se OE fitues disponon të gjithë kapacitetin e duhur financiar për të realizuar kontratën.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në *nenin 77, pika 3, e LPP*, si dhe *nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, nëni 3.1/a, b, c dhe nëni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, **Neni 83:**

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit të ofertës. **Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është: 239.978 (dyqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.**

Kapaciteti ekonomik i “Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizime Fier” Sh.a, është i qëndrueshëm dhe e përballon fondin limit për këtë prokurim dhe kontratën që do të lidhet pas përfundimit.

Sqarim:

Në zbatim të Ligjit Nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, si dhe të njoftimit të përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe APP, respektivisht me nr. 25366 prot dhe nr.8480 prot, datë 30.12.2020, njoftojmë operatorët ekonomikë pjesmarrës që për nënshkrimin e kontratës publike, në përfundim të procedurës, duhet të kenë:

- Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.

- Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Çertifikuar për zgjidhjen softëare-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike".

➤ **2.3 AFTËSITË TEKNIKE DHE PROFESIONALE:**

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2020-2021-2022) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlera totale e të cilave duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet**, të realizuar gjatë ketyre tre viteve.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Arsyetimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1/gërma“c” të Ligjit nr.162, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2 OE ofertues duhet të paraqesë **Autorizim Prodhuesi** ose **distributori zyrtar** për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të provojë me dokument, lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Arsyetimi: Kërkesa e mësipërme pika 2.3.4 është vendosur sipas nenit 40 pika 3, neni 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe në nenin 36 pika 3/b) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Ky kriter është vendosur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i paisur me **Çertifikatën ISO 9001:2015** ose (*ekuivalente/e barazvlefshme me të*) leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e bashkimit të OE, duhet të dorëzohet certifikata ISO sipas zërave që do të merren përsipër sipas akt-marrëveshjes.)

Arsyetimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas nenit 79 pika 1, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në nenin 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është vendosur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit. Çertifikatat duhet të lëshohen nga organet kompetente për të vërtetuar se mallrat i plotësojnë kërkesat e cilësisë duke mundur realizimin në kohë, dhe me cilësi sipas standarteve të kërkuara.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatë **DVGW / WRASN ose ekuivalente**, të aprovimit për përdorimin e ujit të pijshëm për të gjithë mallrat që kanë kontakt me ujin e pijshëm, të leshuar nga një trup i certifikuar ndërkombëtar apo kombëtar i akredituar.

Arsyetimi: Bazuar në nenet 40 pika 3 dhe 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo Çertifikatë ose ekuivalente e saj, kërkohet për t’u siguruar që materialet e përdorura të kenë standartet e duhura të cilësisë, pasi janë në kontakt me ujin e pijshëm i cili duhet të jetë i pastër dhe me parametrat e duhur higjeno-sanitar.

2.3.5 Operatori ekonomik, për matesat e ujit duhet të paraqesë **Çertifikatën MID ose ekuivalente** të vlefshme gjatë kohës së zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Arsyetimi: Bazuar në nenet 40 pika 3 dhe 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.6 Operatorët ekonomik, në momentin e hapjes së ofertave duhet të paraqesin nga një mostër për 35 artikujt/zërat si më poshtë:

Nr	Pershkrimi materialit
1	Mates uji horizontal 1/2"
2	Mates uji vertikal 1/2"
3	Mates uji horizontal 3/4"
4	Mates uji horizontal 1"
5	Mates uji horizontal 1 e 1/4"
6	Mates uji horizontal 1 e 1/2"
7	Mates uji horizontal 2"
8	Saraqineska bronxi 1/2"
9	Saraqineska bronxi 3/4"
10	Saraqineska bronxi 1"
11	Saraqineska bronxi 1 e 1/4"

12	Saraqineska bronxi 1 e 1/2"
13	Saraqineska bronxi 2"
14	Filter bronxi 1/2"
15	Filter bronxi 3/4"
16	Filter bronxi 1"
17	Filter bronxi 1 e 1/4"
18	Filter bronxi 1 e 1/2"
19	Filter bronxi 2"
20	Kundravalvul bronxi 1/2"
21	Kundravalvul bronxi 3/4"
22	Kundravalvul bronxi 1"
23	Kundravalvul bronxi 1 e 1/4"
24	Kundravalvul bronxi 1 e 1/2"
25	Kundravalvul bronxi 2"
26	Niple bronxi 1/2"
27	Niple bronxi 3/4"
28	Niple bronxi 1"
29	Niple bronxi 1 e 1/4"
30	Niple bronxi 1 e 1/2"
31	Niple bronxi 2"
32	Brryl rekord PP 20*1/2" mashkull 16atm
33	Brryl rekord PP 20*1/2" femer 16atm
34	Brryl bashkues PP 20*20 16atm
35	Teflon i madh (<i>ose ekuivalent</i>)

Dorëzimi i mostrave, të bëhet pranë Drejtorisë Teknike, të Shoqërisë Rajonale të Ujësjetës-Kanalizime Fier Sh.A, të mbyllura në një kuti jo transparente, të vulosur mbi të cilin të shënohet:

“Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit “Blerje Matësa Mekanik uji dhe aksesore”. **Data e dorëzimit të mostrave të jetë data e hapjes së ofertave data __.03.2023, deri në orën 10:00.** Mostrat e dorëzuara jashtë këtij afati, nuk do të pranohen nga AK.

- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në kuti.
- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë nr.rendor të Artikullit që përfaqëson.

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr.Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

Arsyetimi: Bazuar në nenin 40 pika 6/gërma(a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; Udhëzimin nr.3 datë 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomik”. Ky kriter vendoset me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë nëse mallrat e ofertuara i plotësojnë specifikimet teknike në DST dhe janë brenda standarteve të kërkuara.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Katalogun e prodhuesit** të mallrave, ku të vërtetohet përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara.

Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen, ku të vërtetohet që mallrat e ofruar, plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara. **Pjesët e katalogut ku tregohen specifikimet teknike, të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.**

Arsyetimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.3.8 Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentin e titulluar **Ofertë Teknike** i paraqitur nga AK në formën e një table (pjesë e dokumentacionit të specifikimeve teknike), kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë listën e artikujve që kërkohen. Dokumenti Oferte Teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr.i produktit	Emërtimi i produktit	Emri i kompanisë prodhuese	Emri i katalogut	KODI i produktit ose nr.i Faqes në katalog ose dok. e noterizuar	Shënim sqarues

Arsyetimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 40 pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Qëllimi i vendosjes të kriterit të sipërcituar ka të bëjë me faktin e orientimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në fazën e ofertimit të dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatorët pjesëmarrës.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një **Deklaratë që merr përsipër transportin** dhe lëvrimin e mallrave drejt ambjenteve magazinuese të Autoritetit Kontraktor.

Arsyetimi: Autoriteti Kontraktor në formulimin e kriterit për kapacitetin transportues të mallrave, i qëndron rigorozisht faktit se OE i cili do të shpallet fitues, duhet të kryejë edhe transportin në destinacion të mallrave objekt prokurimi, për nevojat e AK, i cili nuk do të paguaj shpenzime shtesë për këtë shërbim.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën një mjet transporti me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton (kjo për shkak të peshës që kanë matësat & duhet mjet për lëvizjen e tyre). **Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku OE vet-deklaron mjetin dhe pajisjet që disponon për realizimin e kontratës.**

Arsyetimi: Kjo kërkesë mbështetet në nenin 40 pika 5, gërma (ç), të VKM nr.285 dt.19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

➤ SPECIFIKIME TEKNIKE

• Matësat e Ujit

Sahat Uji 1/2” dhe 3/4” (horizontal dhe vertikal)

Matësi i ujit për ujë të ftohtë duhet të jetë sipas standarteve të Bashkimit Europian 2014/32/EU ose kërkesave të MID (ose ekuivalent).

Matësi duhet të jetë i certifikuar për përdorim për ujin e pijshëm dhe kjo të vërtetohet me certifikatat përkatëse.

Numrat në fushën e matësit që tregojnë matjen e ujit të konsumuar duhet të jenë të mbyllur në mënyrë hermetike, në një kasë që nuk krijon kondensim për të penguar leximin dhe të jenë të ndarë në 2 ngjyra (5 numra me të njëjtën ngjyrë që tregojnë m³ dhe tre numra me një ngjyrë tjetër që tregojnë nënfishat e m³). Matësi duhet të ketë element sigurie për të dalluar nëse është ushtruar forcë mbi fushën e tij për të penguar levizjen e lirë të numratorit.

Matësi i ujit duhet të ofrojë mundësinë dhe të jetë kompatibël me teknologjinë e Leximit Automatik të Matësit, të suportojë vendosjen e një moduli transmetues të të dhënave me valë në përputhje me standartin EN 13757-4 ose ekuivalent. Moduli i leximit të matësit në distancë është pa kabëll (ëireless) dhe transmetimi i të dhënave të jetë i enkriptuar në mënyrë të tillë që informacioni të mos aksesohet nga persona të pa autorizuar, sipas protokollit AES-128 dhe algoritmit CBC. Moduli të ofrojë mundësinë për alarm në rast të përdorimit të fushave manjetike, dritës të fortë për të manipuluar leximin e sensorit.

Të lajmërojë në rast se persona të pa autorizuar shkëpusin modulin nga matësi, në rast se ka kthim uji, rrjedhje uji etj. Bateria e modulit të ketë jetëgjatësi të paktën 9 vjet, frekuenca e transmetimit të jetë 868 - 869MHz, fuqia e transmetimit të paktën 10mE dhe distanca e transmetimit të paktën 350m në fushë të hapur. Moduli i leximit të ketë shkallë mbrojtje IP68 ose më të lartë.

Moduli duhet të ndërveprojë me paisje portabël për mbledhjen e të dhënave. Pajisja të kryejë mbledhjen e të dhënave nga matësat e ujit në një distance deri në 350m dhe të bëjë të mundur kalimin e të dhënave me teknologji pa kabëll (ëireless). Gjithashtu kjo paisje të ofrojë mundësinë për konfigurimin e moduleve të matësive.

Mekanizmi i matësit duhet të ketë minimalisht mbrojtje të trefishtë manjetike për siguri sa më të lartë dhe një matje sa më të mirë kundrejt interferencave të fushave manjetike të jashtme ose të brendshme. Gjithashtu leximi i të dhënave duhet të kryhet anë të një lexuesi optik dhe jo me puls manjetik, në mënyrë të tillë që përdoruesit të mos kenë mundësi të ndalojnë leximin e matësit me anë të përdoirmit të magnetëve. Duke pasur parasysh se përcimi i rrotullimit të turbinës të matësit drejt mekanizmit të matjes bëhet me anë të fushës magnetike, matësat e ofruar duhet të kenë rezistencë të lartë ndaj ndërprerjes të transmetimit të rrotullimeve, si dhe fusha e matësit të ofrojë mundësinë për tu rrotulluar 360°, në mënyrë që të bëhet leximi sa më i thjeshtë, por jo më shumë se 360°.

Buketonat për matësat DN 15 të kenë diametër të brendshëm 15-18 mm dhe gjatësi 37-40 mm. Për matësat DN20 të kenë diametër të brendshëm 20-23mm dhe gjatësi 45-50mm. Buketonat të jenë të certifikuar për përdorim në ujë të pijshëm.

Matësi të jetë i pajisur me teknologjinë kundër ngrirjes, në mënyrë që dhe nëse uji në të ngrin nga temperaturat e ulta, ai të mos dëmtohet.

Matës uji DN 15 dhe DN 20					
Diametri i matësit DN			mm	15	20
Rrjedha e përhershme Q3			m ³ /h	2.5	4
Rrjedha maksimale Q4			m ³ /h	3.125	5
Rrjedha indirekte Q2	Montim horizontal	R100	l/h	40	64
	Montimvertikal	R50		80	128
Rrjedha minimale Q1	Montim horizontal	R100	l/h	25	40
	Montimvertikal	R50		50	80
Rrjedha fillestare			l/h	8	15
Raporti Q2/Q1				1.6	
Temperatura nominale e punës				T30	
Klasa e ndjeshmërisë së tipeve të rrjedhjes				U0, D0	
Rregjistrimi maksimal			m ³	100 000	
Rregjistrimi minimal			l	0.05	
Presioni			bar	16	
Humbja maksimale për Q3 Δp			kPa	63	
Gabimi maksimal i lejuar ndërmjet Q2 dhe Q4			%	± 2	
Madhësia e filetimit				G ³ / ₄	G1

- **Matës uji 1“**

Matësi i ujit për ujë të ftohtë duhet të jetë sipas standarteve të Bashkimit European 2014/32/EU ose kërkesave të MID (ose ekuivalent).

Matësi duhet të ketë mbrojtje të klasit IP 68 ose ekuivalente me të.

Matësi duhet të jetë i certifikuar për përdorim për ujin e pijshëm.

Matësi duhet të ketë ekran dixhital për shfaqjen e të dhënave të matura dhe të ketë të inkuorporuar modulën radio (jo të mbivendosur, pra të jenë një trup) për leximin e të dhënave në distancë nëpërmjet transmetimit të të dhënave sipas protokolleve OMS ose ekuivalente me të.

Matësi duhet të jetë metalik dhe të punojë minimumi 15 vjet me bateri pa përdorur opsionin e transmetimit të të dhënave me valë sipas protokolleve EN 13757-4 ,OMS ose ekuivalente me të dhe minimumi 11 vjet në rastin kur transmeton të dhënat me valë. Bateria e matësit duhet të jetë e zëvendësueshme në mënyrë që matësi të mund të përdoret dhe për më gjatë se 11 vjet. Saktësia e matjes të ujit të jetë R800 ose më e lartë.

Kushtet klimaterike që duhet të suportojë matësi duhet të jenë sipas standartit EN - ISO 4064:2014 ose ekuivalente me të.

Nëpërmjet transmetimit të të dhënave me valë matësi duhet të transmetojë edhe alarme në lidhje me: Bateria (kur bateria është drejt shkarkimit të plotë), Ndërhyrje për manipulim të dhënash (heqjen e matësit të ujit nga sistemi në mënyrë të pa-autorizuar), rrjedhje të vogla të ujit, rrjedhje shumë të mëdha të ujit (mbi limitin e matësit), kur ka sasi të mëdha ajri në ujë, kur ska ujë etj.

Bazamenti i matësit ku kalon uji të jetë plotësisht i hapur në mënyrë që të mos ndikohet nga papastërtitë që mund të ketë uji dhe elementet matës të tij të jenë të mbrojtur nga cdo lloj dëmtimi.

Matësi të ofrojë mundësinë për tu konfiguruar dhe ricertifikuar me anë të komunikimit valor. Gjithashtu matësi të ofrojë mundësinë që të lexohet historiku i të dhënave dhe gabimeve me anë të një smartphone, ose paisje tjetër ekuivalente.

Diametri nominal	DN	mm	25
Rrjedhja e vazhdueshme	Q3	m ³ /h	6.3
Rrjedhja e mbingarkaur	Q4	m ³ /h	7.87
Rrjedhja tranzite	Q2	dm ³ /h	12.6
Rrjedhja minimale	Q1	dm ³ /h	7.87
Niveli i fillimit të matjes	-	dm ³ /h	1.89
Raporti i matjes	R	Q3/Q1	800 ose më të lartë në të gjithë pozicionet e instalimitH ;V;H/V
Raporti		Q2/Q1	1.6

Klasi i temperaturës për EN ose OIML			°C	T30,T50
Klasi i imunitetit për crregullime rrjedhje për EN			-	U0,D0
Raportitregues i numëruesit			m3	10 ⁶
Intervali i tanishëm i ndarjes			dm3	0.01
Gabimi maksimal i lejuar në rang: Q2≤Q≤Q4		ε	%	±2 per uje te ftohte T≤30°C ±3 per uje T>30°C
Gabimi maksimal i lejuar në rang: Q1≤Q≤Q2		ε	%	±5
Klasi i presionit të ujit	Sipas EN	-	bar	MAP16
	Sipas OIML	-	bar	16
Klasi i humbjes të presionit për rrjedhjen Q3	Sipas EN	ΔP	bar	ΔP0.4
	Sipas OIML		bar	0.4
	ngaprodhuesi		bar	0.28
Pozicioni I montimit			-	H; V; H/V
Rrjedhja mbrapa sipas prodhuesit			-	Matesi i ujit i dedikuar per matjen e rrjedhjes mbrapa
Lageshtira relative			%	≤100
Klasi i izolimit IP			-	IP68
Materiali i trupit			-	Bronx
Filetot ne dalje		G	inc	1 1/4"
Gjatësia e matesit të ujit		L	mm	260
Lartësia	H		mm	95
	h		mm	74
Madhësia e numëruesit	D		mm	87
	d		mm	94.5
Pesha		-	kg	1.39

• **Matës Uji 1 ¼” ; 1 ½”**

Matësi i ujit për ujë të ftohtë duhet të jetë sipas standarteve të Bashkimit European 2004/22/EC ose kërkesave të MID (ose ekuivalent).

Matësi duhet të jetë i certifikuar për përdorim për ujin të pijshëm dhe kjo të vërtetohet me certifikatat përkatëse.

Temperatura e ujit të ftohtë ku këta matës aplikohen të jenë deri në 30°C. Presioni i punës së këtyre matësive të jetë minimum 16 bar. Struktura e ndërtimit të matësit duhet të jetë e tillë që të mund të lejojë montimin në 3 pozicione, horizontalisht, anash dhe vertikalisht.

Numrat në fushën e matësit që tregojnë matjen e ujit të konsumuar duhet të jenë të mbyllur në mënyrë hermetike, në një kasë që nuk krijon kondensim për të penguar leximin. Matësi duhet të ketë element sigurie për të dalluar nëse është ushtruar forcë mbi fushën e tij për të penguar lëvizjen e lirë të numratorit. Matësi duhet të jetë konform standartit EN-14154:2005-1, 2 dhe 3 (ose ekuivalente) si dhe duhet të ketë ndjeshmëri të lartë në rrjedhjen e ujin duke matur edhe sasi shumë të vogla të ujit që kalojnë në matës.

Matësat duhet të kenë të inkorporuar në daljet e tyre filtra ose sita në mënyrë që të mos lejojnë papastërtitë të kalojnë në matës. Gjithashtu matësit duhet të kenë mbrojtje ndaj interferencave të fushave të ndryshme magnetike dhe interferencave mekanike. Fusha e matësive të rrotullohet deri në 360°. Matësat e ujit duhet të kenë rezistencë të lartë ndaj gërryerjes.

Matësit e ujit duhet të bëjnë të mundur sinjalizimin me anë të alarmit në rast cmontimi, ndërhyrjeje, rrjedhe të kundërt etj.

Matësat e ujit duhet të jenë konform me standartin ISO 4064-1 për përdorimin në ujë të ftohtë të pijshëm. Gjithashtu ata duhet të jenë konform standartit OIML R49:2004 dhe 2006 në mënyrë që të jenë sa më të saktë në matjen e rrjedhës së ujit.

Gjatësia e matësit 1 ¼“ të jetë 250-270 mm ndërsa gjatësia e matësit 1 ½“ të jetë 290-310 mm.

Matës uji DN 32dhe DN 40					
Diametri I matesit DN			mm	32	40
Rrjedha e perhershme Q3			m3/h	10	16
Rrjedha maksimale Q4			m3/h	12.5	20
Rrjedha indirekte Q2	Montim horizontal	R10 0	l/h	160	256
	Montimvertikal	R50		320	512
Rrjedha minimale Q1	Montim horizontal	R10 0	l/h	100	160
	Montimvertikal	R50		200	320
Rrjedha fillestare			l/h	33	53
Raporti Q2/Q1				1.6	

Temperatura nominale e punes				T30/T50/T13 0
Klasa e ndjeshmerisë së tipeve të rrjedhjes				U0, D0
Rregjistrimi maksimal			m3	99999
Rregjistrimi minimal			l	0.05
Presioni			bar	16
Humbja maksimale per Q3 Δp			kPa	63
Gabimi maksimal i lejuar ndermjet Q2 dhe Q4			%	± 2
Madhesia e filetit				G 1 ½" G2

- **Matës uji 2"**

Matësi i ujit i thatë i tipit Woltman, për ujë të ftohtë duhet të jetë sipas standarteve të Bashkimit Europian 2014/32/EU ose kërkesave të MID (ose ekuivalent).

Matësi duhet të jetë i certifikuar për përdorim për ujin e pijshëm dhe kjo të vërtetohet me certifikatat përkatëse. Peshë e matësit duhet të jetë max , 10 kg për matësin 2" peshë më të vogla janë të pranueshme. Matësi duhet të jetë konform standarit EN-14154:2005-1, 2 dhe 3 (ose ekuivalente) si dhe duhet të ketë ndjeshmëri të lartë në rrjedhjen e ujin duke matur edhe sasi shumë të vogla të ujit që kalojnë në matës. Ai duhet të fillojë të masë rrjedhjet 0.15 m3/h (rrjedhje me sasi më të vogla janë të pranueshme.) Gjatësia e matësit duhet të jetë max, 200mm për matësin DN 2", vlera më të vogla janë të pranueshme. Lartësia të jetë max, 190mm për matësin DN 2"mm, vlera më të vogla janë të pranueshme.

Fusha e matësit që tregon matjen e ujit të konsumuar duhet të jenë të mbyllur në mënyrë hermetike, në një kasë që nuk krijon kondensim për të penguar leximin dhe të ketë minimumi 6 rulona me numra dhe tre shigjeta treguese si dhe fusha e matësit të ofrojë mundësinë për tu rrotulluar 360°. Fusha duhet të jetë e mbrojtur me anë të një kapaku dhe të jetë e mbyllur direkt në trupin e matësit për të shmangur cdo lloj ndërhyrje të mundshme.

Matësi i ujit duhet të ofroë mundësinë dhe të jetë kompatibël me teknologjinë e Leximit Automatik të Matësit, të suportojë vendosjen e një moduli transmetimi të të dhënave. Ai duhet të punojë si në pozicion horizontal dhe shkalla e saktësisë së matjes të jetë R100 (pranohen edhe vlera më të larta), edhe në pozicion vertikal ku shkalla e saktësisë së matjes të jetë R40 (pranohen edhe vlera më të larta).

Mates uji DN			
Diametriimatesit DN		mm	50
Rrjedha e perhershme Q3		m3/h	40
Rrjedha		m3/h	50

maksimale Q4			
Rrjedha indirekte Q2	Montim horizontal	m ³ /h	0.64
Rrjedha minimale Q1	Montim horizontal	m ³ /h	0.4
Rrjedha fillestare		m ³ /h	0.15
Raporti Q2/Q1			1.6
Temperatura nominale e punës			T30
Klasa e ndjeshmerise se tipeve te rrjedhjes			U0, D0
Rregjistrimi maksimal		m ³	999999
Rregjistrimi minimal		l	0.001
Presioni		bar	16
Humbja maksimale e presionit		kPa	ΔP10
Gabimi maksimal i lejuar ndermjet Q2 dhe Q4		%	± 2
Madhesia e filetitimit			Buketona 2 e 1/2"

- **Saracineska Bronzi**

Saracineskat prej bronzi duhet të jenë me levë, të punojnë në presion minimumi 30 bar dhe në temperaturë -15°C deri +110°C. Saraçineskat duhet të kenë mbyllje sferike me kalim të integruar dhe hapje pozicionale. Të dy fundet e saraçineskes duhet të kenë filetim femër dhe të jenë konform standartit ISO 228 (ose ekuivalent). Si trupi dhe komponentët e tjerë të saraçineskës duhet të jenë prej bronzi. Në saraçineskë duhet të jenë të shënuar të dhënat bazë si madhësia e saraçineskës, emri i kompanisë prodhuese ose ndonjë shenjë e markës etj. Të jenë të certifikuar për përdorim për ujin e pijshëm.

Përmasat e Saraçineskave të kërkuara në preventiv janë:

Saracineska 2" ta ketë gjatësinë minimumi 100mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 35mm, pra minimumi 17.5mm nga secili krahu. Leva e saraçineskës të jetë minimumi 140mm dhe lartësia totale e saraçineskës të jetë minimumi 110mm.

Saracineska 1 1/2" ta ketë gjatësinë minimumi 85mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuar të jetë minimumi 33mm, pra 16.5 mm nga secili krah. Leva e saraqineskes të jetë minimumi 140mm dhe lartësia totale e saraqineskes të jetë minimumi 100mm.

Saracineska 1 1/4" ta ketë gjatësinë minimumi 75mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuar të jetë minimumi 31mm, pra 15.5mm nga secili krah. Leva e saraqineskës të jetë minimumi 110mm dhe lartësia totale e saraqineskës të jetë minimumi 82mm.

Saracineska 1" ta ketë gjatësinë minimumi 65mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuar të jetë minimumi 29mm, pra minimumi 14.5mm nga secili krah. Leva e saraqineskës të jetë minimumi 98mm dhe lartësia totale e saraqineskes të jetë minimumi 70mm.

Saracineska 3/4" ta ketë gjatësinë minimumi 55mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuar të jetë minimumi 25mm, pra minimumi 12.5mm nga secili krah. Leva e saraqineskës të jetë minimumi 98mm dhe lartësia totale e saraqineskës të jetë minimumi 64mm.

Saracineska 1/2" ta ketë gjatësinë minimumi 45mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuar të jetë minimumi 22mm, pra minimumi 11mm nga secili krah. Leva e saraqineskës të jetë minimumi 80mm dhe lartësia totale e saraqineskës të jetë minimumi 51mm.

❖ **Kundralvula bronzi**

Kundra valvulat të jenë material 100% bronz. Mekanizmi i bllokimit të rrjedhjes së ujit në të kundërt duhet të jetë i veshur me gominë.

Presioni i punës të jetë minimumi 20 bar dhe temperatura e punës -10°C deri +110°C. Të dy fundet e kundralvules duhet të kenë filetimit femër dhe të jenë conform standartit ISO 228 (ose ekuivalent).

Kundralvula duhet të ketë të shënuar të dhënat bazë në trup si madhësia e saj, drejtimin e rrjedhjes etj. Kundralvulat duhet të jenë të certifikuar për përdorim për ujin e pijshëm.

Përmasat e Kundralvulave përkatësisht sipas radhës në preventiv janë:

Kundralvula 2" ta ketë gjatësinë minimumi 84mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuar të jetë minimumi 35mm, pra minimumi 17.5mm nga secili krah. Lartësia totale të jetë minimumi 95mm.

Kundralvula 1 1/2" ta ketë gjatësinë minimumi 70mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuar të jetë minimumi 30mm, pra 15 mm nga secili krah. Lartësia totale të jetë minimumi 80mm.

Kundralvula 1 1/4" ta ketë gjatësinë minimumi 65mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuar të jetë minimumi 28mm, pra minimumi 14 mm nga secili krah. Lartësia totale të jetë minimumi 72mm.

Kundralvula 1" ta ketë gjatësinë minimumi 56mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuar të jetë minimumi 25mm, pra minimumi 12.5 mm nga secili krah. Lartësia totale të jetë minimumi 60mm.

Kundralvula 3/4" ta ketë gjatësinë minimumi 50mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuar të jetë minimumi 23mm, pra minimumi 11.5 mm nga secili krah. Lartësia totale të jetë minimumi 55mm.

Kundralvula 1/2" ta ketë gjatësinë minimumi 45mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuar të jetë minimumi 23mm, praminimumi 11.5 mm nga secili krah. Lartësia totale të jetë minimumi 45mm

❖ **Filter bronzi**

Filtri të jetë material 100% bronzi. Presioni i punës të jetë minimumi 20 bar dhe temperatura e punës - 15°C deri +110°C. Të dy fundet e filtrit duhet të kenë filetim femër dhe të jenë conform standartit ISO 228 (ose ekuivalent).

Përmasat e filtrave përkatësisht sipas radhës në preventiv janë:

Filtri 2" ta ketë gjatësinë minimumi 120mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 34mm, pra minimumi 17 mm nga secili krah. Lartësia totale të jetë minimumi 85mm.

Filtri 1 1/2" ta ketë gjatësinë minimumi 100mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 30mm, pra minimumi 15 mm nga secili krah. Lartësia totale të jetë minimumi 72mm.

Filtri 1 1/4" ta ketë gjatësinë minimumi 96mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 30mm, pra minimumi 15 mm nga secili krah. Lartësia totale të jetë minimumi 62mm.

Filtri 1" ta ketë gjatësinë minimumi 68mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 27mm, pra minimumi 13.5 mm nga secili krah. Lartësia totale të jetë minimumi 54mm.

Filtri 3/4" ketë gjatësinë minimumi 61mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 24mm, pra minimumi 12 mm nga secili krah. Lartësia totale të jetë minimumi 45mm.

Filtri 1/2" ketë gjatësinë minimumi 50mm. Gjatësia totale e pjesëve të filetuara të jetë minimumi 20mm, pra minimumi 10 mm nga secili krah. Lartësia totale të jetë minimumi 35mm

❖ **Niple Bronx**

Niplet të jenë material 100% bronx. Presioni i punës të jetë minimumi 10 bar dhe temperatura e punës - 10°C deri +100°C. Të dy fundet e nipples duhet të kenë filetim mashkull dhe të jenë conform standartit ISO 228 (ose ekuivalent).Përmasat e nipleve përkatësisht sipas radhës në preventiv janë:

- Niple 1/2" ta ketë gjatësinë minimumi 23mm dhe gjatësinë totale të pjesëve të filetitimit 20 mm pra 10 mm nga secili krah. Gjerësia e nipples të jetë minimumi 21 mm
- Niple 3/4" ta ketë gjatësinë minimumi 24 mm dhe gjatësinë totale të pjesëve të filetitimit minimumi 20mm pra 10mm nga secili krah. Gjerësia e nipples të jetë minimumi 25mm
- Niple 1" ta ketë gjatësinë minimumi 29 mm dhe gjatësinë totale të pjesëve të filetitimit minimumi 24mm pra 12mm nga secili krah. Gjerësia e nipples të jetë minimumi 43mm
- Niple 1 1/4" ta ketë gjatësinë minimumi 31 mm dhe gjatësinë totale të pjesëve të filetitimit minimumi 26mm pra 13mm nga secili krah. Gjerësia e nipples të jetë minimumi 41mm
- Niple 1 1/2" ta ketë gjatësinë minimumi 36 mm dhe gjatësinë totale të pjesëve të filetitimit minimumi 30mm pra 15mm nga secili krah. Gjerësia e nipples të jetë minimumi 47mm
- Niple 2" ta ketë gjatësinë minimumi 45 mm dhe gjatësinë totale të pjesëve të filetitimit minimumi 40mm pra 20mm nga secili krah. Gjerësia e nipples të jetë minimumi 60mm

❖ **Rakorderitë PP**

Rakorderitë shërbejnë për bashkimin dhe përshtatjen e tubave ose rakorderive plastike me përmasa të ndryshme. Trupi i rakorderive të jetë material Polipropilen me rezistencë mekanike të lartë. Produktet duhet të jenë të bombarduara me rreze ultraviolet në mënyrë që mos të krijojnë alga ose baktere. Gjithashtu këto rakorderi nuk duhet në asnjë mënyrë të krijojnë mikroorganizma në ujë të pijshëm. Sipërfaqja e brendshme e produkteve duhet të jetë homogjene dhe nuk duhet të jetë poroze. Produktet

nuk duhet të përmbajnë asnjë tip substance që ndryshojnë shijen ose erën e ujit. Presioni i punës të jetë 16 bar (ose më i lartë) bazuar në standartin SO 1167-1 dhe ISO 1167-4 (ose ekuivalentet e tyre). Metoda e testimit për të kontrolluar nëse ka rrjedhje pas shtrëngimit të rakorderive në tubin plastic duhet të jetë sipas ISO 3458 ose ekuivalent. Rezistenca mekanike e shtrëngimit të rakorderive kundrejt tërheqjes së tubit duhet të jetë testuar sipas standartit ISO 3501 ose ekuivalent me të. Rakorderitë duhet të jenë konform ISO 17885 dhe ISO 3503 (ose ekuivalentet e tyre). Filetimi i tyre të jetë sipas standartit ISO 7-1 ose ekuivalent. Ndryshimi në dimensionet e produkteve të jetë maksimumi ± 0.5 mm nga dimensionet e kërkuara nga AK.

❖ Teflon ose ekuivalent

Shërben për hidroizolim të lidhjes së rakorderive me njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë eliminohet rrjedhja e ujit. Të jetë material PTFE.

• Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

❖ GRAFIKU I LËVRIMIT

Lëvrimi i mallit të bëhet sipas nevojave të AK, partia e I brenda muajit të parë, ndërsa pjesa tjetër e mallit sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Afatet e lëvrimit: **12 muaj nga momenti i nënshkrimit të Kontratës.**

Shënim: këto afate mund të ndryshojnë në varësi të situatave, emergjencave dhe nevojave të punës.

NJËSIA E PROKURIMIT